

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN, DEGA NË NOVOBËRDË-

Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares Emine Salihu, Ref. e larte Mimoza Mehmeti, në lëndën penale kundër të akuzuarit F..M... nga Fsh.K..., K.Novoberdes, për shkak të veprës penale Vjedhje Pylli ,nga neni 349 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan- Departamenti i përgjithshëm PP.II-nr.825/2020 të datës 26.06.2020, të cilën e përfaqësonte prokurorja e shtetit Sllavica Popoviq, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 15.03.2021., në prezencë të palëve po të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri F.. M..., pa pseodonim dhe emër te rrejshëm, nga i ati A... dhe e ëma E., e lindur G., i lindur më dt....., ne Gjilan, me vendbanim në Fsh.K., K.Novobërdës, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në sallonin e veturave ... “...” në Prishtinë-....., i martuar, pa fëmijë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për ndonjë vepër tjetër penale.

Është fajtor

Sepse ,

-Më datë 04.05.2020, rreth orës 13.00h, në territorin e Fshatit J., Komuna e Novobërdës, në pyllin e pronës private, pronë e të dëmtuarit B... M..., në vendin e quajtur “”, në parcelën me nr..... i pandehuri F...M..., me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 65 copa drunjë të llojit Bung, me diametër ne cung 14-18cm, në lartësi të drurit 7m, N.1.30 cm, me vëllim të përgjithshëm 6.76 m³ dhe 25 copa drunjë të llojit qarr me diameter ne cung 2-50cm, me gjatësi 3-50m, me vëllim të përgjithshëm 0.70 m³, të cilat i ka bartur me traktorin e markës, me ngjyre të, në këtë mënyrë të dëmtuarit , i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 865.28 Euro.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 2, të KPRK-së

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e cituara ligjore ,nenin 4, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 71, 72, si dhe nenin 365 të KPRK-së, dhe nenin 451 të KPPK-ës të akuzuarit,

E GJYKON

Për veprën penale të dispozitivit të akuzës me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) Euro të cilin dënim i pandehuri ka për ta paguar nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajve , të cilin dënim i pandehuri nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë veper tjetër penale , në të kundërtën gjykata do t'ia revokoj dënimin me kusht .

I dëmtuari K..M..., nga Fsh.B., për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Të akuzuarit i kthehen mjetet e sekuestruara përkohësisht: sharra motorike, 1 ram dhe 1 sopatë, me nr. të rastittë datës, nga Ministria e punëve te brendshme.

Obligohet i akuzuari t'i paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25(njëzetë e pesë) Euro, si dhe në emër të harxhimeve procedurale shumë të përllogaritur në llogarinë përfundimtare të kësaj gjykate, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në konform të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit i pandehuri F....M..., obligohet të paguajë taksën në shumë prej 30 ero.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.825/2020 të datës 26.06.2020, ndaj të pandehurit F.. M..., nga fsh.K., K.Novoberde, për shkak të veprës Vjedhje pylli nga neni 349 par.2 të KPRK-së.

I pandehuri F. M... pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar ka deklaruar : e kam kuptuar aktin akuzues që është lexuar nga ana e prokurorit të shtetit dhe e pranoj në tërësi veprën penale e cila më vëhet në barrë sipas dispozitivit të kësaj aktakuze dhe atë për çdo pikë të aktaakuzës ,nga se këtë veper penale e kam kryer në kohën ,vendin dhe mënyrën të përshkruar si në dispozitiv të kësaj aktakuze , për të cilën veper penale e kuptoj natyren dhe pasojat e pranimin të fajit,pranimin e fajit e bëjë

vullnetarisht, pa kurfarë dhune dhe presioni dhe se aktakuza nuk përmban as një shkelje të qartë ligjore ose gabime teknike, ndiej keqardhje dhe pendothem shumë dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepër penale ose të natyrës së njëjtë nuk i kam ditur pasojat e kësaj vepre penale, lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të butë dhe betohem para gjykatës se kjo do të jetë hera e parë dhe e fundit. Është hera e parë që jam pranë gjykatës, drunjtë e marrur si në aktakuzë i kam marrë vetëm për nevojat e mija personale për të ndertuar një mbulojë për pula, lus gjykatën që të më shqiptojë një dënim sa më të butë.

Përfaqësuesja e akuzës, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar ka deklaruar: Nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sepse pranimi është i mbështetur në provat tjera materiale në shkresat e lëndës andaj konsideroj se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për pranimin e fajësisë dhe i propozoj gjykatës që në tërësi ta aprovoj pranimin e fajësisë së të pandehurit.

Pas dëgjimit të prokurores së shtetit dhe të akuzuarit, gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 2 të KPP për pranimin e fajësisë, nga se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet nga faktet e çështjes nga aktakuza e cila nuk përmban as një shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj ,duke u bazuar në këtë që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi gjendjen faktike :

Se i pandehuri F.. M., nga fsh. K...r, K.Novobërdë, e ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.2 të KPRK-së.

Gjyqëtarja e vetme gjykuese, shpalli fajtor të pandehurin F... M..., për veprën e cekur më lartë nga se veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit të pandehurit gjykata ia ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ,sipas nenit 73,të KPRK-së ku si rrethanë veçanarishtë lehtësuese gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajsinë, sjelljen korrekte në gjykatë ,ka shprehur keqardhje për kryerjen e kësaj vepre , është penduar si dhe faktin se më parë nuk ka qenë e dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, është hera e parë që është pranë gjykatës. Ndërsa , nuk ka gjetur ndonjë rrethanë pasaqërisht rënduese.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit ndaj të pandehurit F... M...

, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit ,nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 të KPRK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 1.2 të KPPRK-së.

Nga të cekurat e më sipërme e në bazë të nenit 365 të KPPK-ës,u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN ,DEGA NË NOVOBËRDË

Departamenti i përgjithshëm

P.nr.39/2020

Më:15.03.2021

*Ref. e larte
Mimoza Mehmeti*

*Gjyqtarja
Emine Salihu*

KËSHILLA JURIDIKE :Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në gjykatën e Apelit në Prishtinë ,në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit .Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj gjykate.

Pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 15.03.2021, pas vendosjes, gjyqtarja në presencë të palëve publikisht shpalli këtë:

NË EMËR TË POPULLIT

AKTGJYKIM

I pandehuri Fejzullah Mustafa, nga Fsh.Kllobukar, K.Novoberdes, me gjeneraliet si ne shkresat e lendes.

Është fajtor

Sepse ,

-Më datë 04.05.2020, rreth orës 13.00h, në territorin e Fshatit Jasenovik, Komuna e Novobërdës, në pyllin e pronës private, pronë e të dëmtuarit Bekim Maliqi, në vendin e quajtur “ Kosmotant”, në parcelën me nr.0042-0 i pandehuri Fejzullah Mustafa, me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 65 copa drunjë të llojit Bung, me diametër ne cung 14-18cm, në lartësi të drurit 7m, N.1.30 cm, me vëllim të përgjithshëm 6.76 m³ dhe 25 copa drunjë të llojit qarr me diameter ne cung 2-50cm, me gjatësi 3-50m, me vëllim të përgjithshem 0.70 m³, të cilat i ka bartur me traktorin e markës IMT-539, me ngjyre të kuqe, në këtë mënyrë të dëmtuarit , i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 865.28 Euro.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 2, të KPRK-së

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e cituara ligjore ,nenin 4, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 71, 72, si dhe nenin 365 të KPRK-së, dhe nenin 451 të KPPK-ës të akuzuarit,

E GJYKON

Për veprën penale të dispozitivit të akuzës me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) Euro të cilin dënim i pandehuri ka për ta paguar nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajve , të cilin dënim i pandehuri nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë veper tjetër penale , në të kundërtën gjykata do t’ia revokoj dënimin me kusht .

I dëmtuari Kujtim Maliqi, nga Fsh.Busavatë, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Të akuzuarit i kthehen mjetet e sekuestruara përkohësisht: sharra motorike, 1 ram dhe 1 sopatë, me nr. të rastit 2020-CN-47 të datës 04.05.2020, nga Ministria e punëve te brendshme.

Obligohet i akuzuari t'i paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25(njëzetë e pesë) Euro, si dhe në emër të harxhimeve procedurale shumë të përlllogaritur në llogarinë përfundimtare të kësaj gjykate, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në konform të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit i pandehuri Fejzullah Mustafa, obligohet të paguajë taksën në shumë prej 30 ero.

*Ref.e larte
Mimoza Mehmeti*

*Gjyqtarja
Emine Salihu*

Gjyqtarja pasi lexoi dispozitivin e aktgjykimit ,në prani të palëve ,në seancë të hapur, shkurtimisht prezantoi arsyerat e aktgjykimit.

Pas shshpalljes së aktgjykimit, gjyqtarja në kuptim të nenit 368 të KPP i udhëzon palët për të drejtën në ankesë

Se kundër këtij aktgjykimi është e lejar ankesa gjykatëes së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit ,me shkrim përmes kësaj gjykate .

Gjyqtarja, gjithashtu njoftoi palët për detyrimet e tyre se deri në përfundim të procedurës ta njoftoj gjykatën për çdo ndryshim të adresës.

Vërtetojnë:

*Ref.e lartë
Mimoza Mehmeti*

*Gjyqtarja
Emine Salihu*